



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.404/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi, anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rifat Rrustemi, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Shtërpcë, paraqitur kundër Këshillit të Vendvotimit (KVV), për shkak të parregullsive në Vendvotim, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa ZL.Anr.404/2017 e datës 23.10.2017 e Rifat Rrustemi, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Shtërpcë,

### A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 23.10.2017 nga Rifat Rrustemi, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Shtërpcë, me të cilën pretendon se në vendvotimin 2305D/01R në Firajë të Shtërpcës, komisionarët e këtij VV kanë asistuar qytetarët për të votuar gjatë gjithë ditës.

Si dëshmi ankesës i ka bashkangjitur kopjet e librit të votimit të qendrës së votimit.

Paneli, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### **Refuzohet si e pabazuar**

Paneli pasi që shqyrtoi ankesën, vlerësoi se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, të Rifat Rrustemi, nga Shtërpca, se në një vendvotim me nr. 2305D/01R, në Firajë të Shtërpcës ka pasur parregullsi gjatë procesit të votimit, në Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, janë të pabazuara, pasi që në provat që ka bashkangjitur parashtruesi i ankesës nuk mund të vërtetohen pretendimet e tij ankimore, ashtu siç parashihet me nenin 117 të LZP-ë.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa**

Zl.Anr. 404/2017 me datën 24.10.2017.

**Kryesuesi i Paneli**  
**Zyhdi Haziri**



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-***